



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 13134/5
Prot

Vlorë, më: 30.10.2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 5

Datë 13.10.2023 Ora: 16:30

Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nen 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 nen 5, pika 1,2,3,4 nen 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha; Deputete Teuta Rama; Zv. kryetari i Këshillit Bashkiak- z. Novruz Rokaj; Kryetare e Rajonit 5- Brisilda Cobaj, nenkryetarët e bashkisë; Daut Zeraj-Sekretar i Këshillit Bashkiak,, Drejtori i buxhetit dhe finances-Hiqmet Haxhaj, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, shoqeri civile dhe Media, (Ne takim moren pjese mbi 42 persona, listeprezenza bashkangjitur)

Takimin e hapi Administratorja e Rajonit 5-Brisilda Cobaj- Faleminderit që jeni prezent në takim! Jemi mbledhur në kuadër të dëgjesave për planifikimin e buxhetit.

Rajoni 5 përbëhet nga 30 mijë banore dhe 9700 familje. Ka zona informale. Kryetari është djalë i lagjes. Ta shohim si bashkëbisedim me njëri tjetrin por pa lënë pa përmendur dhe punën e mirë që është bërë për përmirësimin e shërbimit të pastrimit, gjelbërimit dhe fasadat e pallateve.

Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Ky takim sic e parashikon ligji, zhvillohet për konsutimet për hartimin e projektbuxhetit 2024. Dua të përfshijë problemet e ngritura në fushatë e

Jemi marr me pastrimin si shqetësim kryesor. Fidanishtja. Kemi cuar projekt për sistemin kanalizimit.

i parë është projekti i financuar nga Fondi për vitin tjeter për rehabilitime dhe investime për esat e vjetra te rruga e re, fasadat dhe jo vetem për imazh, rreth 50 ndërtesa. Shpresojmë të me ritëm. E shikoj si qendrën e Vlorës është hyrja e saj dhe është prioritet i joni. Kemi marr portësi nga Fondi i Zhvillimit për riasfaltim për 10 segmente, rrugë të qytetit, përfshirë këtu dhe Rajoni 5. Drejtori i Urbanistikës do të jap detaje për buxhetin. Dëgjesë me publikun që eksioni mbi infrastrukturë të ndahet në mënyrë të drejtë buxheti për projektet e parashikuara zonën tuaj.



Planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë

Per me shume klikoni linkun
<https://fb.watch/nGIWvuTuU5/?mibextid=v7YzmG>

Hiqmet Haxhiaj:Drejtori i Financës dhe Buxhetit- Përshtendetje. Dua mendimin dhe sygjerimin tuaj për buxhetin 2024. Projekt buxheti afatmesëm 2024-2026 është hartuar me miratimin e këshillit bashkiak. Treguesit kryesorë afatmesëm janë;

Të ardhurat totale 2024-2026 janë 2,659.506 (2 miliard..)

Shpenzimet janë për:

Administratën publike, zjarrfikësen, ujitje dhe kullim.

Investimi për vitin 2024 parashikohen në masën rreth 377,748 mijë lekë..

Proioritet për Rajonin 5 janë parashikuar këto investime:

Reabilitimi dhe rikonstruksion i Lagjes Kushtrimi në vlerë 100 milion lëkë.

Rikonstruksionin e rrjetit tercial të kanalizimeve, ujrave të zeza.

Investimet për rrugët e brendshme, për trotuarët dhe lulishtet. Në total për gjithë qytetin 250 miljon lekë, pra për Rajonin nr.5 është 1/5 -50 miljon lekë.

audio Mehmetaj-Drejtor i Urbanistikës: Përshëndetje në vijim të investimeve në shkëpunim me Fondin deri te kryqëzimi, “Ruga e Paqes” janë miratuar projekt investime: sistemi i qendërzuar, për boljerët

ond rikonstruksion për ish fushën e aviacionit

250 milion lek projekt ide për zonën para shkollës “Halim Xhelo”.

Banor: Skemi ujë!

Ermal Dredha: Uji. Fol Elona.

Elona Hodaj – Drejtore SHAUK. Ky është i vetmi rajon që s’ka investime dhe ujësjellës. Ne jemi ndërmarrje riparimi. Aq mundësi kemi, riparim në sistemin kryesor. Në burim, pika kryesore e furnizimit s’ka prodhim uji nga avaria. Duhet vënë në funksion pika prodhuese te Pusi i Mezinit. Investimi po shikohet në Pus Mezin sepse ka lidhje të jashtligjshme. Jemi duke rakorduar me banorët, fillon investimi në Pus Mezin. Për depozitat, projekti i ri do i heqi depozitat pas 2 vjetësh dhe do i kaloj nëntokë.

Niko Zharra-Banor: Administrata është nivel i dobët, s’kanë respekt për qytetarët. Për takime dita e enje me zotin kryetar, të zbatohet pritja me qytetarët.

Ermal Dredha: Dita e enje ka patur shumë takime 40-60 qytetarë. Unë kam patur edhe angazhime institucionale për të mundësuar projektet që po flasim këtu. Cdo punë bëhet në bashkëpunim me nënkyetaren e bashkis, znj.Irena, e cila më përcjell shqetësimet. Cojani kërkesat edhe asaj! Të jemi praktik në cfarë kërkojmë e cfarë të presim. Administrata dhe nënkyetarët e bashkisë do ju dëgjojnë. Jam I bindur që do funksionoj.

Petref Hoxha, Banor: Është shtruar një rrugë që ndihmon 100 familje. Ju falenderoj! Fillimi i mbarë, ka pastërti, lulishte, ka ndryshuar situata. Kam gjetur përgjigje për problemet te administrata e rajonit dhe bashkisë. Ujësjellësi, 200 familje në lagje janë kompletuar dhe na është përgjigjur ndërmarrja.

2 pikat që kam:

kanali i madh, shkon në veri të serave. Ka 10-15 ditë që është mbyllur fare. Sjell shirat dhe është problem në hidrovor dhe ju shkojnë familjeve ujrat e zeza nga përmbytja.

Ruga “Bektash Cakrani”, kanë bërë mur dhe është burim për aksidentet.



Edmond Leka-Drejtor NSHP- Për kanalin është problem për gjithë rajonet. Nga ana e kanalit duhet të ketë 8m largësi. Janë shtëpitë në rëzë të kanalit. Duhet ndërhyrë me projekt të madh.

Xhemal Banor: Falenderimet i merrni me përgjegjësi. Jemi ca të nënës e ca të babës me 2 standarte.

-Lagja Kushtrimi me projekte përgjysëm.

-Janë si rrugë pa trotuare me kanale.

-Ndricimi vende vende.

-Kanali pastrohet por Inertet janë hedhur në kanal prapë.

Ermal Dredha: Ju lutem, të dëgjojmë njëri tjetrin, që të shkruajmë ndonjë gjë për buxhetin. Sjam këtu për të gënjer.

Banor/Ish Fabrika e tullave: Administrata të na respektoj. Kemi kërkuar takim për ujin e pijshem. Jeni i vetmi që dini lagjen tonë. Uji i pijshëm, rruga, kanalizimet. Janë urgjente për tu zgjidhur. Poshtë te serat ka vajtur uji i pijshëm te ne jo! Te ish fabrika e tullave. Vetem disa familje. Duhen 40m kanal. Uji vjen me fekale, I bëmë analizat! Uji është i papijshëm!

Lumturi Shkurti: L. Osman Haxhiu uji vjen vetëm 2 herë. Humbasim rrugën. Rruga e Lirimit, rruga e Kucit. Duam rruge për të dal te spitali. S'kalon as ambulance e as zjarrfikëse dhe të rregullohen tubot. Jam shumë e kënqur nga dr e ujësjellësit. Pati difekt, u rregullua tanë të mbulohen e të myllen. Duhet asfaltuar. Lagja Vrenezi ka shtëpi të vjetra duhen rregulluar. Të shtrohet rruga dhe mbas pallatit. Pallati te shkolla Rilindja është gati në të shembur. Të sistemohet.

Banor: Kanali dhe ndricimi. Ka ardhur të shpia ime, të mbulohet kanali se është problem. Gjithashtu dhe rruga është problem.

Ermal Dredha Gjithë kjo zona juaj do 3 miljon lekë. Kanali dhe gjithë zona do ndërhyhet. Kanali do të mbulohet nëse është e lejueshme.

: Kanali të mbulohet!

mond Leka: është pastruar kanali, por duhet prishur muri.

uzim Aliaj: Kryetarja e rajonit na ka pritur. Falenderoj edhe drejtoreshën e ujësjellësit, puset na rrregulluan, na është përgjigjur. Vlora ka probleme. Jemi të ndërgjegjshm. Po vuajnë por kemi etur përgjigje në adminisritatë. Certifikatat e shtëpisë që kanë blerë fëmijët me kontrata me ronarët dhe ndërtuesit. Paguajnë taksat për këto shtëpi por si do i zgjidhim? Duam Certifikatat!

Ermal Dredha: Problemi zgjidhet me ASHK.

Bekim Biba: Jam ne lagjen e Elektrikut. Falenderoj ujesjelles kanalizimet, kemi ujë të pijshëm. Edhe për ndricimin jemi në rrugë. Por nuk kemi rrugë dhe asfaltim dhe gangrene është dhe problem I ujrave të zeza.

Klaudio Mehmeti: E kemi planifikuar me FSHZH dhe në një fazë të dytë do bëhet zona e Elektrikut.

Banor: Rruga Kanina.30-40 familje janë të bllokuara nga rruga. Problem është uji i pijshëm dhe ujrat e zeza. Kemi 32 vjet.

Endora Celoaliaj: Përshëndetje dhe suksese! Lagja "Hysni Muka". Ska shumë banorë të lagjes sonë sot në takim, nga pamundësia. Është lagje e diskriminuar. Asfaltimi mungon. Ndricimi mungon nga stacioni I fundit deri ne Pus Mezin. Kanalizimet e ujrave të zeza. Zjarrfikësja nuk kalon. Ambulanca nuk kalon dot. Sektori i mjedisit nuk po ndihet. Ska aktivitete rinore.

Kastriot Meja: Lagja Kushtrimi. Dua takim në lidhje me investimet dhe rrëgullimet për banesat sociale.

Ermal Dredha: Kemi pas presion edhe nga EKB për ndarjen e godinës. Buxheti do shpërndahet sipas rajoneve. Presim vendimet e KB për ndarjen e godinës si banesa sociale. Do aplikohet në dy faza. Janë 75 banesa. Komisioni me pikëzimet do vlerësoj ndarjen ku duhet, të banesave. Lista që cohet në këshill krijon përplasje mes këshilltarëve. Është ngritur grup pune për verifikimin e fazës së dytë. Do ta bëjmë sic duhet por duhet durim. Ju thash qytetarëve. Kjo listë do cohet në këshill por duhet selektim i saktë sipas kritereve.

Do mblidhet këshilli jashtë radhe dhe do vendos kriteret e pikëzimit për banesat sociale.

Banor: Je i pari që na ke mbledhur. Kemi një problem shumë të madh me kanalin. Mbytemi. Do pastrohet kanali?

Ermal Dredha: Është ndërtuar mbi kanal. E pastrojme dhe mbushet prapë. Projeksiioni i paraviteve 90 ska patur ndërtesa. Legalizimi.. janë ndërtuar shtëpitë sipas qejfit.

Elona Hodaj-Drejtore-UK: kanali pastrohet cdo vjeshtë dhe gjithmonë ka mbetje, dyshek goma dhe e bllokojnë.

ual Dredha: Do bëjmë maksimumin. Ajo zonë ka qënë fidanishte, është ndërtuar sipas qejfit. Të investim 3 milion euro. E cuam te Fondi i Zhvillimit. Të presim, të bëhet.

nor: Bastri: Jetoj në lagjen Kushtrim, rruga Kanina. Është zënë nga ndërtimet dhe ka probleme kanalizimet. Erdhi eksperti i dërguar nga kryetari. Toka është tjetërsuar. Është e rrethuar. Janë familje atje. Duam të lirohet rruga për zjarrfikësen dhe ambulancën. Rruga ëshët baltë. Jemi 5 ë pa ujë, si do e zgjidhim? Mbushim ujë te kalaja.

anor- Biznes. Kopsht. Te Pusi Mezinit, rruga ku banoj ka probleme me kanalizimet dhe ujrat e zeza. Vetëm 10m tubo duhen.

Brisilda Cobaj: Rikonstruksion i zyrës së rajonit 5.

Konceptoi: Albana Naçi

Koordinatore për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

